



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

V E N D I M

NR. 2, DATË 10 /04 /2025

PËR

**MIRATIMIN E STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK
PROCEDURË E VEÇANTË” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “LIDL
SHQIPËRIA – QENDËR LOGJISTIKE”, ME SUBJEKT “LIDL SHQIPËRIA”
SHPK NUIS M21312006S**

Në zbatim të neneve 8, 9, 17, 18, 24 dhe 27 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

VLERËSOI:

- Projekti i investimit është në përputhje me kriteret e parashikuara në nenin 8 pika 6, të Ligjit Nr. 55/2015, i ndryshuar.
- Projekti i investimit propozohet të realizohet nga subjekti aplikues “LIDL SHQIPËRIA” SHPK NUIS M21312006S.
- Subjekti aplikues “LIDL SHQIPËRIA” SHPK është pjesë e kompanive të rrjetit ndërkombëtar gjerman Schwarz Group, i cili është një lider ndërkombëtar në industrinë e shitjes me pakicë, i pozicionuar në 31 shtete.
- Vlera e investimit të projektit të investimit “LIDL Shqipëria– Qendër Logjistike” i plotëson kriteret e parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikohet të jetë mbi 105,000,000 (njëqind e pesë milion) Euro.
- Projekti i investimit synon të zhvillohet në një sipërfaqe totale prej 200.000 m², e cila ndodhet pranë zonës logjistike portuale në Porto Romano, Durrës.

- Projekti i investimit parashikon ndërtimin e një qendre logjistike e cila do të shërbejë si objekt kryesor për magazinimin e produkteve me shumicë. Produktet e magazinuara synojnë të furnizojnë si tregun shqiptar, duke lehtësuar grumbullimin, mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e produkteve vendase, ashtu si dhe promovimin dhe eksportin e jashtëm të këtyre produkteve. Subjekti synon gjithashtu të operojë në tregun shqiptar duke krijuar operacione të shitjes me pakicë përmes një rrjeti të gjerë supermarketesh.
- Sipërfaqja e synuar ndodhet brenda konturit të “Masterplanit të Portit të Ri Tregtar të Integruar të Durrësit në Porto Romano”, me zhvillues Autoritetin Portual Durrës, miratuar me Vendim KKTKU me nr. 09, datë 27.07.2022 “Leje zhvillimi për objektin “Porti i Durrësit – Porto Romano”.
- Autoriteti Portual Durrës në cilësinë e Zhvilluesit të Projektit të Portit të Ri Tregtar të Integruar të Durrësit në Porto Romano, në bashkëpunim me institucionet përkatëse si ASHK, AZHT dhe ASHSH, ka marrë të gjitha masat për vijimin e ndjekjes së procedurës së nisur për realizimin e procesit të shpronësimit, në funksion të implementimit të Masterplanit të sipërcituar.
- Projekti i investimit i plotëson kriteret e punësimit të kërkuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikon të punësojë rreth 2500 (dymijë e pesëqind) persona.
- Autoriteti Portual i Durrësit pas përfundimit të procedurave administrative do të disponojë të gjithë sipërfaqen e gjurmës sipas “Masterplanit të Portit të Ri Tregtar të Integruar të Durrësit në Porto Romano”.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Miratimin e Statusit “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Veçantë” për projektin e investimit “LIDL – Shqipëria Qendër Logjistike” me subjekt “Lidl Shqipëria” sh.p.k. NUIS M21312006S, sipas gjurmës në Aneksin 1 të këtij vendimi.
2. Projekti i investimit strategjik “LIDL – Shqipëria Qendër Logjistike” do të zhvillohet nga subjekti “Lidl Shqipëria” sh.p.k. NUIS M21312006S.

3. Projekti i investimit strategjik parashikon realizimin e investimit mbi 105,000,000 (njëqind e pesë milion) Euro.
4. Projekti i investimit strategjik do të zhvillohet brenda gjurmës së Projektit të Ri Tregtar të Integruar të Durrësit me Zhvillues Autoritetin Portual Durrës, sipas Vendimit të KKTKU me nr. 09, datë 27.07.2022.
5. Statusi “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Vecantë” i jepet projektit të investimit “LIDL – Shqipëria Qendër Logjistike” për një periudhë 3 (tre) vjeçare.
6. Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike, përkatësisht neni 21, neni 22 dhe neni 27 i Ligjit Nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, masat mbështetëse që i jepen projektit të investimit strategjik janë si më poshtë:
 - a) Miratohet masa mbështetëse e kryerjes së procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përshpejtuara, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike;
 - b) Miratohet masa mbështetëse e asistencës në lidhje me dhënien e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme për realizimin e projektit, në përputhje me afatet e parashikuara sipas legjislacionit të investimeve strategjike;
 - c) Miratohet në parim masa mbështetëse vënie në dispozicion të sipërfaqes prej 20 ha për zhvillimin dhe realizimin e këtij projekti investimi strategjik me destinacion zhvillimin e projektit.

Miratimi përfundimtar në funksion të realizimit të projektit strategjik, do të parashikohet në aktet administrativo-ligjore që do të prodhohen pas përfundimit të procedurës në zhvillim për implementimin e masterplanit të Portit të Ri Tregtar të Integruar të Durrësit në Porto Romano. Në çdo rast kontrata e qirasë për vënie në dispozicion të projektit të investimit të pasurisë së paluajtshme në pronësi të Autoritetit Portual Durrës, do të negociohet dhe nënshkruhet po nga autoriteti zhvillues APD sipas legjislacionit në fuqi.

7. Ngarkohet Autoriteti Portual Durrës, në cilësinë e zhvilluesit të zonës pas përfundimit të procedurave administrative dhe disponimit të pronës, të lidh kontratë qiraje afatgjatë me shoqërinë “Lidl Shqipëria” sh.p.k me NUIS M21312006S, sipas planit të veprimit miratuar me këtë vendim.

8. Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit strategjik “LIDL – Shqipëria Qendër Logjistike” konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit strategjik të këtij projekti me procedurën e vecantë, Komiteti i Investimeve Strategjike ka të drejtë të revokojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.
9. Mënyrat, procedurat, afatet dhe organet zbatuese për ofrimin e masave mbështetëse përcaktohen në planin e veprimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
10. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike, në asnjë rast nuk do të konsiderohet investim, qoftë sipas kuadrit vendas ashtu edhe atij ndërkombëtar, në fuqi në Republikën e Shqipërisë, duke qenë se miraton në parim realizimin e një projekti investimi, materializimi i të cilit do të bazohet në përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve që parashikojnë legjislacionet sektoriale në fuqi.
11. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i njoftohet investitorit.

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

BLENDI GONXHJA

MINISTËR I FINANCAVE

PETRIT MALAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANILA DENAJ

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

LAURA PLAKU (SARO)

PLANI I VEPRIMIT

PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT STRATEGJIK “LIDL-SHQIPËRIA
QENDËR LOGJISTIKE” ME SUBJEKT “LIDL SHQIPËRIA” SHPK NUIS
M21312006S

1. Përmbajtja e planit të veprimit

Plani i veprimit për realizimin e një projekti strategjik, përcakton:

- Procedurat lehtësuese që do të zbatohen për realizimin e investimit strategjik dhe afatet e përshpejtuara brenda të cilave duhet të kryhen;
- Shërbimet ndihmëse që do të ofrohen ndaj projektit strategjik;
- Masat mbështetëse që do të nevojiten për mbështetjen e investimit strategjik;
- Organet përgjegjëse për zbatimin e investimit strategjik;
- Detyrat përkatëse për secilin organ të përfshirë në realizimin e investimit strategjik;
- Programin e punës për realizimin e investimit strategjik të detajuar në faza;

2. Zbatimi i planit të veprimit

Plani i veprimit monitorohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, e cila koordinon veprimtarinë me organet e tjera shtetërore dhe me investitorin.

Autoritetet publike, të përfshira në mënyrë direkte apo indirekte në realizimin e një investimi strategjik, kanë detyrimin ligjor në lidhje me trajtimin me prioritet të procedurave dhe brenda afateve të përshpejtuara. Këto organe kanë detyrimin ligjor që të bashkëpunojnë dhe t’i japin Agjencisë, sqarime, informacione, lejet, licencat, autorizimet, mendimet dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e një projekti investues strategjik.

3. Informacione të përgjithshme mbi Planin e Veprimit të projektit “LIDL-Shqipëria Qendër Logjistike”

Ky plan veprimi për realizimin e këtij projekti investimi, përcakton masat, procedurat dhe afatet, në lidhje me shërbimet dhe lehtësimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e projektit investues strategjik, në të cilin përcaktohen angazhime, detyra dhe afate konkrete për institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha fazat e realizimit dhe zbatimit të projektit.

Plani i veprimit, u hartua nga grupi operacional i krijuar pranë Agjencisë Shqiptare të

Zhvillimit të Investimeve, bazuar në karakteristikat e projektit të propozuar. Për këtë qëllim, propozuesi i investimit strategjik, ka listuar dhe treguar qartësisht në momentin e paraqitjes së aplikimit, procedurat, shërbimet dhe masat mbështetëse konkrete, të cilat kërkon të përfitojë nga shteti shqiptar, për realizimin e investimit.

Plani i veprimit u hartua pasi propozimi i paraqitur mbi investimin strategjik të projektit “LIDL-Shqipëria Qendër Logjistike” është vlerësuar paraprakisht dhe ka një rekomandim pozitiv të Komitetit të Investimeve Strategjike në lidhje me miratimin e tij. Autoriteti përgjegjës për miratimin e planit të veprimit për çdo projekt strategjik të miratuar është Komiteti i Investimeve Strategjike.

4. Hapat procedurale

Propozimi nga investitori:

Investitori “Lidl Shqipëria” sh.p.k., kur paraqiti projektin e investimit tek AIDA, në përputhje me legjislacionin, ka specifikuar edhe listën e procedurave, shërbimeve dhe masat mbështetëse që kërkon për realizimin e investimit strategjik.

Masat mbështetëse që kanë një vlerësim pozitiv nga KIS janë si më poshtë vijon:

Masat e kërkuara	Rekomandimi	Institucioni përgjegjës	Procedura për masën e kërkuar e detajuar në faza. Detyrimet sipas institucioneve përgjegjëse	Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesë subjekti	Afati	Kosto
Vendosje në dispozicion dhe marrjen me qira të pasurisë me sipërfaqe prej 20 ha pranë zonës logjistike portuale në Porto Romano, Durrës.	PO Të negociohet dhe të lidhet një kontratë afatgjatë qiraje, qoftë edhe me të drejtë rinovimi, ndërmjet autoritetit zhvillues dhe subjektit sipas legjislacionit sektorial në fuqi.	APD				

Mbështetje e investimit me infrastrukturë mbështetëse	PO ME KUSHT	APD BASHKIA DURRËS	Subjekti do të ketë akses në infrastrukturën e parashikuar në masterplanin e Portit të Ri Tregtar të Integruar të Durrësit në Porto Romano, i cili lë të hapur mundësinë e ndërveprimit të subjekteve të interesuar të cilët aktiviteti i tyre ndërvepron me operacionet e shumëllojshme portuale.			
Asistencë për marrjen e të gjitha lejeve, licencave dhe autorizimeve (infrastrukturë, ndërtim dhe operim) për Qendrën Logjistike Lidl me afate të përshpjetuara në përputhje me kuadrin ligjor strategjik të investimeve.	PO	AIDA dhe organe të tjera kompetente.	- Investitori paraqet tek AIDA dokumentacionin e nevojshëm që kërkohet nga legjislacioni sektorial për miratimin e licencave/lejeve/autORIZIMEVE.			
Kryerje e procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përshpjetuara, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike;	PO	AIDA		Ligj 55/2015 i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim.		

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

BLENDI GONXHJA

MINISTËR I FINANCAVE

PETRIT MALAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANILA DENAJ

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

LAURA PLAKU (SARO)